

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"D&J" SHPK

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Sot me datën 24 Qershor 2014, ne ortakët themelues kemi krijuar një Shoqëri me

Përgjegjësi të Kufizuar me Emrin: "D&J" Sh.P.K.

Themeluesit e Shoqërisë janë

1. Zhaneta Coban SPAHIU e datëlindjes 11.02.1968, lindur në Vlorë dhe banues në, Tiranë (Ruga "A. Mojsiu", A.303 Tiranë 2/Orion, Njesia Bashkiake nr 4, mbajtës i kartës së identitetit me nr. G85212189H.dhe,
2. Daniel Dashnor Spahiu, i datëlindjes 23.05.1996, lindur në Përmet, dhe banues në, Tiranë (Ruga "A. Mojsiu", A.303 Tiranë 2/Orion, Njesia Bashkiake nr 4, mbajtës i kartës së identitetit me nr. J60623048K.

3.

NENI 2

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në rruga e "Dibres", pallati 7 kate, pas Universitetit te Mjeksise, Ap.62

Shoqëria mund të krijojë filiale, zyra përfaqësimi, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Faqja zyrtare web e Shoqërisë do të jetë www.D&J.al

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e:

- Konsulencës ekonomike, bujqësi, blegtori dhe ushqimit duke përfshirë planet menaxhimit të cilësisë, mjedisit, turizmit dhe agro-turizmit.
- Sherbimeve financiare, kontabilitetit dhe sistemit fiskalë;
- Sherbimeve të auditimit të brendshem në sektorin publik dhe privat, sipas standardeve kombetare dhe nderkombatre (INTOSAI), te auditimi
- Sherbimeve ne fushën e arsimit parauniversitar, kopshte, shkolla, sherbime trajnimi për punonjësit mësimore,kurse profesionale etje.
- Sherbimeve komisionere si agjenci sherbimeve financiare, kembime valutore, trasferta parash, agjenci sherbimi ne fushen e trasportit kombëtar e ndërkombëtar ajror, toksore e detare.
- Import-Eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të makinerive për prodhim bujqësor dhe blegtoral.;
- Hartimit të projekteve të sistemimit malor, të shfrytëzimit të qëndrueshëm, pyllëzimit, mirëmbajtjes dhe të përmirësimit (ri cungim e trajtim me prerje kulturore) të pyjeve;
- Kultivim, grumbullim, përpunim, import –eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë bimësh mjekësore e eterovajore, perimesh, drithërash dhe frutash të freskëta, konservuara dhe përpunuara;
- Shërbimeve hoteliere, restorante dhe turistike brenda dhe jashtë Shqipërisë;
- Sherbimeve artizanale,elektrike hidrauluke,ndertimi,sanitare, krijimit dhe mimbajtjes se ambjenteve te gjelbra,krijim dhe mimbajtje sistem IT etje.

NENI 4

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "D&J" SHPK është 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 100 kuota, secila me vlerë nominale 1.000 (njëmijë) lekë.

Kontributi i ortakëve është i ndarë si vijon:

1. Zhaneta Spahiu, zotëron 51 kuota baras me 51 % të kapitalit, pra 51 kuota me vlerë 51.000 lekë

2. Daniel Spahiu zotëron 49 kuota baras me 49 % te kapitalit, pra 49 kuota me vlerë 49.000 lekë

NENI 5

TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë të trashëgueshme.

Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore midis bashkëshortëve, si edhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarries ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit ne QKR

Për transferimin e kuotave të kapitalit themeltar midis ortakëve do të respektohet e drejta e parablerjes midis ortakëve, dhe në rast të transferimit të kuotave tek të tretët duhet të kërkohet miratimi i shoqërisë.

NENI 6

KALIMI ME KONTRATË I KUOTAVE

Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratori. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.

Administratori mund të refuzojë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratori nuk është dakord me personin të cilit i kalon kuota.

Nëse Administratori refuzon të regjistrojnë kalimin e kuotës, ai do të njoftojë për mospranimin personin të cilit i kalohen kuota, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

NENI 7

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të papërcaktuar.

NENI 8

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- (1) Administrator i shoqërisë do te jetë **Znj. Zhaneta Spahiu**, e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.
- (2) Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.
- (3) Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve. Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.
- (4) Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo përfajje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- (5) Administratorit i paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhje lidhur me përbushjen e detyrave të tyre.

NENI 9

MARRËVESHJET E NDALUARA

- (1) Administratorit ose ortakëve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdo lloj forme, të marrin hua të shoqëria, të japid pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve.
- (2) Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.
- (3) Kjo masë ndaluese zbatohet gjithashtu ndaj bashkëshortëve paraardhësve dhe pasardhësve të personave të cituar në paragrin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.

NENI 10

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

- (1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- (2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit, ajo mund të marrë vendime

të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

- (3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- (4) Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontributë në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tillë.
- (5) Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) përcaktimin e kushteve dhe rregullave për punësimin e personave të jashtëm sipas nevojave të Shoqërisë.
 - n) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 11

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

- (1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve

- të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
- (2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

NENI 12

TË DREJTAT E SHOQËRISË DHE ORTAKËVE

- (1) Shoqëria ka të drejtë të lidhë kontrata dhe të nënshkruajë marrëveshje brenda dhe jashtë vendit.
- (2) Shoqëria përgjigjet ndaj te tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur, duke u përashtuar përgjegjësia personale e çdo ortaku.
- (3) Ortakët përballojnë humbjet deri ne kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.
- (4) Ortaku ka të drejtë të marrë në çdo moment raportin e administrimit inventarët, illogaritë vjetore, për tre vitet e fundit financiare, duke qenë i ndihmuar po të jetë nevoja nga një ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nënshtronhet detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional.
- (5) Një ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 1/10 e kuotave të kapitalit mund të kërkojnë ne rrugë gjyqësore caktimin e një eksperti për paraqitjen e një raporti për një ose disa vendime administrative.
- (6) Ortakët mund të caktojnë një përfaqësues ligjor për administrimin e çështjeve të veçanta ligjore, siç është p.sh. përfaqësimi në gjykatë etj. Honorarët vendosen në marrëveshje midis ortakëve dhe përfaqësuesit ligjor.

NENI 13

DETYRAT E ORTAKËVE

Ortakët detyrohen të depozitojnë kontributin e tyre në kapitalin themeltar.

Çdo ortak detyrohet të sigurojë në kohë dhe plotësisht detyrimet e tija ndaj shoqërisë dhe ortakëve të tjerë.

Kur ortaku nuk i përgjigjet detyrimeve, atëherë ortaku tjetër, pasi e ka njoftuar dhe ai nuk ka plotësuar detyrimin kërkon dëmshpérblimin.

NENI 14

VOTAT E ORTAKËVE

- (1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të

- autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- (2) Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.
- (3) Të gjitha votat e pa kundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

NENI 15

VOTIMI ME PROKURË

- (1) Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratori):

"D&J" SHPK

Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, në cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më, ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më 20....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Nënshkruar më..... 20.....".

- (2) Në rastet kur dëshirohet tu jepet ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund te miratohet nga Administratori):

"D&J " SHPK

Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, ne cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më, ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më 20....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Kjo formë do të përdoret për vendimet e përmendura më poshtë:

Vendimi Nr. 1 *pro *kundër.

Vendimi Nr. 2 *pro *kundër.

Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme. Nënshkruar më..... 20.....”.

- (3) Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratori depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjeter brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.
- (4) Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*), ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

NENI 16

EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR

Emërimi dhe shkarkimi

Shoqëria "D&J" SHPK mund të emërojë një ekspert kontabël të autorizuar.

Emërimi i ekspertit kontabël të autorizuar bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

Shqyrtimet e bëra pa caktuar ekspert kontabël te autorizuar në rastet e detyruara me ligj si edhe raportet e ekspertëve kontabël të autorizuar, të emëruar në kundërshtim me rregullat e parashikuara në ligj janë të pavlefshme.

Ekspertët kontabël të autorizuar emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve për një periudhë të caktuar financiare, në rast gabimi ose pengimi, eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet nga funksionet e tij me vendim gjykate.

Detyrat e ekspertit kontabël të autorizuar

Garanton që llogaritë vjetore janë të rregullta dhe të hartuara me sinqeritet konform ligjeve dhe jep një pasqyrim besnik të rezultatit të operacioneve të vitit të kaluar

financiar si dhe të gjendjes financiare të trashëgimisë së shoqërisë në fund të këtij viti financiar.

Verifikon librat e llogarive dhe fondet e shoqërisë dhe kontrollon përshtatjen e kontabilitetit të saj me legjislacionin në fuqi.

Verifikon përputhjen me llogaritë vjetore të informacioneve të dhëna në raportin e administrimit nga administratori përpara asamblesë së ortakëve si dhe në dokumentet që i janë dërguar asamblesë mbi gjendjen financiare dhe llogaritë vjetore.

Eksperti kontabël i autorizuar është i detyruar t'i bëj të njojur administratorit dhe asamblesë së ortakëve.

- a) -Kontrollet dhe verifikimet që ka kryer dhe sondazhet që ka bërë.
- b) -Pjesët e bilancit dhe të dokumenteve të tjera të kontabilitetit në të cilat sipas tyre duhet të ishin bërë ndryshime duke bërë gjithashtu edhe të gjitha vërejtjet e duhura mbi metodat e vlerësimit të përdorur në përpilimin e këtyre dokumenteve.
- c) -Parregullsitë dhe pasaktësitë që ka zbuluar.
- d) -Përfundimet që rrjedhin nga vërejtjet dhe korrigimet e mësipërme mbi rezultatet e vitit financiar, të krahasuara me ato të vitit financiar të mëparshëm.

Eksperti kontabël i autorizuar thirret nga asambleja e përgjithshme e ortakëve, kur shqyrtohet mbyllja e llogarive të vitit të kaluar financiar dhe sa herë kërkohet nga asambleja e ortakëve

Përgjegjësitë ligjore të ekspertit kontabël.

Eksperti kontabël i autorizuar është përgjegjës ndaj shoqërisë dhe ndaj te tretëve për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga fajet dhe nënveftësimet në ushtrimin e funksionit të tij, por nuk është ligjërisht përgjegjës për shkeljet ligjor të kryera nga administratori me përashtim të rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk i ka zbuluar dhe raportuar ato asamblesë së ortakëve.

Honorarët e ekspertit kontabël.

Honorarët e ekspertit kontabël të autorizuar paguhën nga shoqëria.

NENI 17

DIVIDENTËT

(1) Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të bëhet referim në dispozitat e legjislacionit tregtar dhe atij shqiptar në përgjithësi.


NENI 22

Ky statut është hartuar në 4 (katër) origjinalë.

ORTAKËT E SHOQËRISË

" D&J " SHPK

1. *Daniel Spahiu*



2. *Zhaneta Spahiu*



Tiranë / 24. 06. 2014